



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 3209/Prot.
6

Koplik, më 12/12/2025

V E N D I M

Nr. 50, datë 11.12.2025

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës Financiare për familjen e Zotit Bashkim Binak Delaj banesa e te cilit është djegur nga zjarri

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe ne mbledhje e datës 11.12.2025 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur ne Ligjin 139/2015“Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54, shkronja“dh“,Ligjin 45 neni 30,41 pika 1,2,3, datë18.07.2019“Per Emërgjencat Civile“, VKM_ së nr.329 date 16.05.2012 kreu III/I “Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“,Udhëzimi i perbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263,datë 224.05.2013 „Për kriteret dhe procedurat dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKB Nr.81..date 31.12.2024 Per miratimin e buxhetit të Vitit 2025.

V E N D O S I:

1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për ndihmën e menjëherëshme financiare familjes së z. **Bashkim Binak Delaj** në vlerën **322.744,5** (treqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e dyzet e katër, presje pesë) lekë, për djegjen e banesës së tij nga zjarri.

2-Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin“**Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**“, në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhë për **vitin 2025** të miratuar me VKB. .81..datë 31.12.2024 në programin_“Perballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet në raste fatkeqesie“.

3-Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe per familjen e z. **Bashkim Binak Delaj** në vlerën e dëmit nga ana ndertimore në shumën **387.649**(treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë) lekë, 50% i saj është **193.824,5** (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e katër, presje pesë) lekë dhe elektroshtëpijake ne shumën **257.900**(dyqind e pesëdhjete e shtate mije e nenteqind) lekë,ku 50% i saj është **128.950** (njeqindntenjete tetë mijë e nenteqind e pesëdhjetë) lekë . Sipas preventivave të Komisionit të

Vlerësimi të dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe. Vlera totale e dëmeve është **645.549** (gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë ku 50% i saj është **322.774,5** (treqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër, presje pesë) lekë

4- Ngarkohet administrata e Bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **322.774,5** (treqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër, presje pesë) lekë.

5- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.

6- Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr.139/2015 „Për vetëqeverisjen vendore“

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 12.12.2025

